

**KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE**

Nr 283 prot

Tiranë, më 19.07 2023

**VENDIM**

Nr. 4 datë 19.07.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 13/7/2023**

Këshilli Konsultativ, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe Vendimin Nr. 910 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për çështjet, objektet konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, objekt konsultimi në mbledhjen e datës 13/7/2023 vendosi:

1. Për projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 696 datë 16.08.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoriatit Qendror dhe të rregullave përmajtjen dhe administrimin e portalit unik" e-inspektimi", propozuar nga Kryeministria, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Pika 5 kreua VI germa "c" dhe "ç" propozojmë të hiqet fjala "për shërbimin civil" dhe "nëpunësin civil" dhe të vendoset sipas legjisacionit të punës në fuqi.
  - Kreu V, pika 3 dhe 4, nuk është e nevojshme njoftimi i Inspektoriatit Qendror për emërimet dhe lirimet e Inspektorëve Vendor pasi cënon autonominë vendore, përderisa emërimet e punonjësve bëhen online si dhe te diskutohet platforma me inspektoriatet e bashkive.
2. Për projektvendimin "Për miratimin e rregullores së përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit", propozuar nga Kryeministria, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.

3. Për projektvendimin “**Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror në Republikën e Shqipërisë**”, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Pika 2.1 “Plani i Emergjencës” duhet të përbajnjë dhe të plotësojnë kriteret e mëposhtme; duke shtuar paragrafin me këtë përbajtje; “ndërveprojnë/komunikojnë /informojnë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në juridikcionin lokal të ndërhyrjes, ose Këshillin e Qarkut kur ndërhyrjet janë rajonale. Këshilli i Qarkut merr masa dhe ndërvepron me NJQV brenda juridikzionit administrativ.
  - Pika 2.2, të shtohet paragafi me këtë përbajtje; Plani i Emergjencës duhet tu vijet në dispozicion për dijeni dhe koordinim mbrojtjes civile në bashki/ MC rajonale dhe qendrore.
  - Pika 3.4.2 të shtohet paragafi si vijon; “në çdo rast të sipërpërmendor duhet që të njoftohen mbi këto treziqe njësitë e pushtetit vendor (bashki apo këshilla qarqesh) sipas juridikzionit të ndërhyrjes territoriale.
  - Pika 4.2 “Ekipi i krizave”. Një ekip krizash do të këshillojë dhe mbështesë ministrinë përgjegjëse dhe të shtohet; “Njësitë e qeverisjes vendore për energjinë përpara dhe gjatë një krize”.
  - Pika 4.4, “Niveli i paralajmërimit të hershëm kushtet, treguesit dhe implikimet”, të shtohet paragafi si vijon: “Njësitë e pushtetit vendor njoftojnë komunitetin e tyre për paralajmërimin”.
4. Për projektvendimin “**Për miratimin e planit të veprimit parandalues të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë**”, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
5. Për projektvendimin “**Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake**”, propozuar nga Ministria e Brendshme, anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Neni 18, “vlerësimi i punonjësit” të saktësohet periudha e vlerësimit të punonjësit, e cila është lënë në diskrecion të eprorit sepse me fjalën “vazhdimësi” nuk është e qartë.
  - Neni 30, të shtohet paragafi “eprori duhet të kontrollojë pajisjet funksionale të punonjësit të shërbimit para marrjes së shërbimit si dhe rregullsinë e uniformës dhe gjatë shërbimit”.
  - Të diskutohet rregullorja me bashkitë dhe shoqatat si dhe bashkitë e vogla të përshtatin rregulloren tip sipas specifikës së bashkisë.
6. Për projektvendimin “**Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrën, shenjat dhe përdorimin e mjeteve lëvizëse të policisë bashkiake**”, propozuar nga Ministria e Brendshme, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;
  - Të konsultohet me bashkitë mbi shenjat dalluese të policisë bashkiake

7. Për projektligjin “**Për mbrojtjen e të dhënave personale**”, propozuar nga Ministria e Drejtësisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
8. Për projektvendimin “**Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 419 datë 25.6.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave të lejeve të tipit A, B, C për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri të kushteve për leje respektive të mjedisit dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet deri në lëshimin e lejeve nga QKB” të ndryshuar**”, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
9. Për projektvendimin “**Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale**”, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit u shprehën parimiشت dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;
  - Të zgjerohet baza ligjore për hartimin e projektvendimit shtuar shkronjën “a” dhe “b”, të pikës 4, shkronjën “a” të pikës 6, pikës 7 të nenit 12 të ligjit 57/2020 “Mbi Pyjet”, duke u riformular si vijon: “Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetues, dhe të shkronjës “a”, “b”, “c” të pikës 4, të shkronjës “a”, pika 6 dhe të pikës 7, të nenit 12 të ligjit nr.57, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, me propozimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave”.
  - Pika 9 e kapitullit III duhet riformular si vijon; “Afati i dhënies në përdorim të fondit pyjor kombëtar nga Këshilli i Bashkisë është jo më pak se një vit, me të drejtë ripërsëritje dhe në përputhje me afatet dhe planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, të miratuara për sipërfaqen e kërkuar”.
  - Të shtohet pika 9.1 me këtë përbajtje: “Fondi pyjor kombëtar jepet në përdorim vetëm për pyjet dhe kullotat në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore” në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, shkronjën “e”.
  - Në pikën 3, kapitulli III, të shtohet një paragraf me këtë përbajtje: ”Për sipërfaqen pyjore/kullosore të marrë në përdorim, përgjigjet për dëmtimet e paligjshme, prerjet ilegale, shpyllëzimet, mbrojtjen nga zjarri dhe gjuetia e paligjshme”, me qëllim rritjen e përgjegjësisë për miradimin e sipërfaqes pyjore.
  - Të korrigohet te kutia e dytë dhe e tretë, duke shtuar “për ndërtim/rikonstruksion banese” që lidhet me saktësimin e qëllimit të përdorimit të lëndës drusore.
10. Për projektvendimin “**Për përashtimin nga ndalimi i gjuetisë për qëllime shkencore pasvaksinale, të kafshëve të vaksinuara, në kuadër të projektit IPA 2020, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së tërbimit- Faza-IV**”, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
11. **Rekomandim i përbashkët i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatit të Popullit “Për marrjen e masave dhe zbatimin e legjisacionit përkatës për sigurimin e përfaqësimit të barabartë gjinor në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri”**,

propozuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.

**Znj. Romina KUKO**  
**Zv/Ministër i Brendshëm**  
**Bashkëkryetar**



**Z. Aldrin DALIPI**  
**Kryetar i Shoqatës së Këshillit**  
**të Qarqeve të Shqipërisë**  
**Bashkëkryetar**

